VENDIM
Nr.622, datë 11.6.2009

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, TË SIPËRFAQES 6467.31 M2, PJESË E PRONËS NR.974 "BAZA NDIHMUESE, SHËNGJIN, LEZHË" DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të sipërfaqes 6467.31 (gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë pikë tridhjetë e një) m^2, pjesë e pronës nr.974 "Baza ndihmuese, Shëngjin, Lezhë" dhe të objekteve, që gjenden në këtë territor, "Truproje MRU" me sipërfaqe 74(shtatëdhjetë e katër) m^2, kabinë gjeneratori, me sipërfaqe 10(dhjetë) m^2, bankinë e gjuajtësit detar, me sipërfaqe 295(dyqind e nëntëdhjetë e pesë)m2,dhe bankina e shkallës, me sipërfaqe 147(njëqind e dyzet e shtatë) m^2, për zgjerimin e kapacitetit të portit të Shëngjinit, rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe të infrastrukturës ndihmëse të peshkimit dhe për riparimin e anijeve të peshkimit në vend.

2. Heqjen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të sipërfaqeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, si dhe t'i tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha